
**New Greek manuscripts at the Central State Archive of Albania.
A first presentation.**

Abstract: *Up to the present, among the documents at the Central State Archive of Albania, the place of honor has been given to the Collection of Codices, to the greek byzantine and post-byzantine manuscripts. Lately, the number of 119 known manuscripts and fragments of manuscripts has been enriched with 11 other manuscripts, newly found. They were preserved at the Library of the CSA, without being catalogued at earlier times and, eventually, were never made known to the scientific public.*

In our paper we will present for the first time these newly found manuscripts of CSA, which date between the 14th and the 19th century. Their content, written in Greek (with some exception), is: 1) Oneirocritikon of Achmet, son of Sirin (Ὀνειροκριτικὸν τοῦ Ἀχμέτ, υἱοῦ Σιρίν); 2) Nomokanon; 3) short geography of Athanassios Psalidas; 4) Political geography; 5) Liturgical texts in Greek and Vlachian with Greek characters; 6) a notebook with the notes of two pupils, copies of theological texts; 7) a notebook, grammar and mathematic exercises, between them some folios written in the alphabet of Theodor Haxhifilipi; 8) a notebook containing grammar exercises and French-Greek-French dictionary, Italian-Greek-Italian dictionary, Latin-Greek-Latin dictionary; 9) pastoral texts by Christophor the Spiritual, Mr. Misail and Eugen Boulgaris, manuscript from the 18th century; 10) Psalms of David and the Nine Odes, printed book of the 17th century, containing handwritten folios dating at the end of the same century, possibly copied by Ghinos, priest and oikonomos of Pogonians; 11) Dypticha of the Monastery of Philanthropon, manuscript from the 14th century.

Keywords: *byzantine manuscripts, post-byzantine manuscripts, interpretation of dreams, Central State Archive – Albania, Monastery of Philanthropon, Theodore Hadjiphilipides, Athanasios Psalidas, Eugenios Boulgaris, Ginos of Pogonians.*

1 Arkivist dhe paleograf pranë AQSh.

Ndër studimet që kanë parë dritën e botimit gjatë ca më shumë se dy dekadave të fundit, janë bërë përpjekje të natyrave të ndryshme, studimore, promovuese apo ekspozuese, të cilat kanë pasur në qendër të vëmendjes hulumtimin dhe interpretimin e rëndësisë që paraqet Fondi “Kodikët e Shqipërisë” i Arkivit Qendror Shtetëror. Këto botime, që herë përsërisin punën e studiuesve paraardhës gjatë shek. XX dhe imitojnë, ca herë të tjera përbëjnë risi të mirëfillta në lëmishten e botimeve historike në përgjithësi, apo të historisë së librit dhe studimeve historike në veçanti. Sigurisht, studimet e deritanishme nuk kanë shterur gjithçka përsa i përket Koleksionit të Kodikëve, ndodhemi ende në fazën fillestare të studimeve. Mirëpo, megjithëse ka ende punë për t’u bërë, gjithmonë dalin pyetjet: A kemi kodikë të tjerë? A ekzistojnë ende libra të periudhës bizantine dhe pas-bizantine, të shkruar në greqisht, të ndodhur në rafte arkivash, bibliotekash, apo duar koleksionistësh? Në këtë artikull do t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve dhe do të prezantojmë disa dorëshkrime të tjera, të cilat i janë shtuar kohëve të fundit Fondit “Kodikët e Shqipërisë”.

1. *Oneirokritikon* nga Ahmet ibn Sirim. (figura 1) Tekst i kopjuar në shek. XVI (figura 1), shkruar në letër, përmban 96 fletë me përmasa 145 x 110 mm. Dorëshkrimi nuk ka kapakë, por ruan një pjesë të dëmtuar të lidhjes. Fashikujt përbëhen prej 6 apo 8 fletësh dhe nuk bartin numërtim. I pari prej këtyre fashikujve mungon, duke bërë që teksti të fillojë me kreun 15. Dorëshkrimi përfundon me kreun 272. Është kopjuar nga një kopist anonim. Teksti, siç e thotë dhe titulli, është një interpretim ëndrrash. Autorësia i atribuohet Ahmetit, të birit të Sirimit, informacion që jepet edhe në f. 3 të dorëshkrimit: “Ἦλθεν ἄν(θρωπ)ος ἰρότις/σας με τὸν Ἀχμέτην, τὸν υἱὸν Σιρεῖμ τὸν ὄνιρω|κριτῆν τοῦ προτουσηβούλου Μαμμουνή...” (Erdhi një njeri dhe më pyeti, mua, Ahmetin, të birin e Sirimit, interpretuesin e ëndrrave të këshilltarit të parë, Mamunit)². Në f. 13 dorëshkrimit i është ngjitur një letër e trashë, bashkëkohore, e cila mban nr. 289. Përveç kësaj shenje, dorëshkrimi nuk mban asnjë shënim tjetër, duke mos na dhënë asnjë informacion mbi kopistin, prejardhjen apo përdoruesit e mëparshëm. Dorëshkrimi u gjet në Bibliotekën e AQSh dhe mban numrin e Dosjes 103 në Fondin “Kodikët e Shqipërisë” në AQSh.

2 *Interpretimi i ëndrrave sipas Ahmetit, të birit të Sirimit* është një variant i krishterë i interpretimit të ëndrrave, huazuar nga arabët islamikë. Periudha në të cilën datohet teksti është fundi i shek. IX ose shek. X. Autorësia i atribuohet Ahmet ibn Sirim-it ndoshta si pasojë e një keqkuptimi të njërit prej kopjuesve të tekstit. Për më shumë shih: Maria Mavroudi, *A Byzantine Book on Dream Interpretation, the Oneirocriticon of Achmet and its Arabic Sources*, Brill 2002, fq. 5 për datimin dhe fq. 32-62 për problemin e emrit të autorit.

2. Nomokanon, i tipit *πάνυ ὠφέλιμον καὶ πλουσιώτατον*. Dorëshkrim i shek. XVI (figura 2), shkruar në letër, përmban 138 fletë me përmasa 158 x 110 mm. Kapakët mungojnë, ruhet vetëm lidhja, e cila paraqitet e dëmtuar. Fashikujt përbëhen prej 8 fletësh, të numërtuar në fletën e parë dhe të fundit të fashikullit. Ky numërtim, që është i së njëjtës kohë me shkrimin e tekstit, paraqitet i çuditshëm, pasi për një fashikull prej 8 fletësh përdor dy numra progresivë: në fletën e parë të fashikullit jepet, p.sh., nr. β', kurse në të fundit nr. γ'; në fletën e parë të fashikullit pasardhës jepet nr. δ', kurse në të fundit nr. ε', e kështu me radhë deri në fund. Fashikulli me nr. α' mungon. Dorëshkrimi ka 18 fashikuj, ku i pari numërtohet me nr. β', i fundit me nr. λστ', nga i cili ruhen vetëm dy fletët e para (f. 37, 38), të shkëputura nga lidhja. Përmbajtja e dorëshkrimit është, si vijon:

1-13^v Parathënie (jo e plotë): inc. ...καὶ ἀκούσιον διαλλάγηαι, καὶ ἔνωσον αὐτὸν τῇ ἀγίᾳ σου ἐκκλησίᾳ... des. ... εἰς δὲ τὴν περὶ τούτου δήλωσιν, ἐγένετο καὶ τὸ παρὸν συστατικὸν γράμμα, καὶ ἐπέδωθη αὐτῷ....

13^v – 14: Κανόνες συνοδικοὶ καὶ ἀποστολικοὶ καὶ τοῦ μεγάλου Βασιλείου, καὶ ἐτέρων ἀγίων νεωστὶ συντεθέντες καὶ διορθωθέντες κατὰ τάξιν διὰ τὸ ἀσύγχυτον....

14 – 138^v: Kap. 1 – 271

Teksti është kopjuar nga 3 kopistë anonimë. Kopisti A ka shkruar fletët 1-64^v, kopisti B ka shkruar fletët 65-128^v, dhe kopisti C ka shkruar fletët 129-138^v. Dorëshkrimi nuk mbart shënime të tjera, përveç, edhe këtu, një flete letre bashkëkohore me nr. 117, ngjitur në f. 136^v. Dorëshkrimi u gjet në Bibliotekën e AQSh dhe mban numrin e dosjes 104 në Fondin “Kodikët e Shqipërisë” në AQSh.

3. Gjeografi nga Athanas Psalidha. Titulli i plotë: *Γεωγραφία σύντομος τοῦ σοφολογιωτάτου Ἀθανασίου Παλίδας, διὰ χειρὸς Χρίστου Ἀλβανίτου, 1819, Ἰουνίου 20, Ἰωάννηνα* (Gjeografi e shkurtër nga i gjithëurti Athanas Psalidha, kopjuar nga Kristo Alvanitu, Janinë, më 20 qershor 1819.). Dorëshkrimi përmban 254 fletë letre me përmasa 173 x 110 mm (figura 3). Kapakët janë prej kartoni, veshur me lëkurë, lidhja e mirë. Përmbajtja e dorëshkrimit është, si vijon:

f. 4-24^v: Περὶ Γεωγραφίας γενικῶς. Τὶ εἶναι γεωγραφία; (*Mbi gjeografinë në përgjithësi dhe ç'është gjeografia*).

f. 24^v-251^v: Përshkrim i botës.

f. 252^v-253: Tabela e përmbajtjes.

Teksti është kopjuar, sipas të gjitha gjasave, nga Kristo Alvanitu, emri i të cilit jepet në faqen e titullit. Në f. 2^v dorëshkrimi mban dhe shënimin e zotëruesit të dikurshëm: Καὶ τόδε ὑπάρχει τοῦ ἁγίου Βελεγράδων κυρίου Ἰωάσαφ (Ky libër është pronë e të shenjtit të Beratit, zotit Joasaf). Duke pasur parasysh informacionet që na vijnë nga të tjerë dorëshkrime të Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, por edhe nga koleksioni i librave të shtypur³, i qëndrojmë bindjes se ky libër ka qenë pronë e Joasafit të II-të, Mitropolit i Beratit në vitet 1802-1855⁴. Në anën e brendshme të kapakut të parë kemi një copë letër të ngjitur në kohëra moderne, mbi të cilën shkruhet numri 144. Nuk dihet rrugëtimi i dorëshkrimit nga biblioteka e Mitropolitit të Beratit, Joasafit të II-të, deri në Bibliotekën e AQSh. Sot dorëshkrimi është pjesë e Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja 105.

4. Gjeografi politike e botës. Pa datë, shek. XIX. Dorëshkrimi përmban 171 fletë letre me përmasa 150 x 110 mm. Kapakë prej kartoni të veshur me lëkurë. Lidhja e mirë. Përmban gjeografinë politike të botës. Autori i tekstit është anonim, po ashtu dhe kopisti. Dorëshkrimi ndodhej në Bibliotekën e AQSh, iu shtua Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja 106.

5. Liturgji të Shën Joan Gojartit dhe Shën Vasilit, në greqisht dhe vllahisht. Kopjuar në gjysmën e dytë të shek. XIX apo në fillim të shek. XX. Dorëshkrimi (figura 4) përmban 51 fletë me përmasa 105 x 145 mm. Mban kapakë kartoni, lidhja në gjendje të mirë. Përmbajtja:

f. 1-12^v: Liturgjia e Joan Gojartit, vllahisht me germa greke.

f. 13-32^v: Liturgjia e Joan gojartit, greqisht.

f. 33-51^v: Liturgjia e Shën Vasilit të Madh, greqisht.

Kopisti i tekstit është anonim, po ashtu dhe data. Në anën e brendshme të kapakut ndodhet shënimi, shkruar me laps: “Kujtim prej Andrea Kona. Durrës, më 18/8/928”. Dorëshkrimi vjen nga Fondi “Koleksion Dokumentesh (486), Dosja 2412⁵. U sistemua në Fondin “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja 107.

3 Shih: Andi Rembeci, Sokol Çunga, “Koleksioni i librave të vjetër të Arkivit Qendror Shtetëror shtypur në greqisht”, *Albanohellenica* 6 (2018), fq. 235-242, .

4 Ἀνθίμος Ἀλεξούδης, *Σύντομος Ιστορική Περιγραφή της Ιεράς Μητροπόλεως Βελεγράδων*, ἐν Κερκύρῃ 1868 fq. 121.

5 Sot Fondi “Koleksion Dokumentesh” është shpërbërë, nuk ekziston më. Dokumentet që e përbënin janë shpërndarë në fonde të tjera, në varësi të përmbajtjes së tyre.

6. Fletore shënimesh. Është shkruar nga dy nxënës, Joan dhe Athanas Kolotova (figura 5), të cilët kanë lënë emrat e tyre në f. 17^v, dhe datën 23 shkurt 1868 (f. 18). Dorëshkrimi përmban 85 fletë me përmasa 145 x 105 mm. Kapakë të thjeshtë kartoni, lidhje e mirë. Përmbajtja:

- f. 2-17^v: Rrëfenja të dobishme nga jeta e atit tonë oshënar Andonit të madh.*
- f. 18-29: Letra e Zotit tonë Jezu Krisht, gjetur mbi varrin së Përmbisenjtës zonjës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonëvirgjërës Mari.*
- f. 29-35: Nga (Simeon) Metafrasti, dialog i zhvilluar mes Elias dhe kusarit në Parajsë.*
- f. 36-66: Jeta dhe vdekja e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë.*
- f. 66^v-67: Kronikë e vizitës së murgut Kozma në Berat dhe Myzeqe, e vrasjes, hedhjes në lumë dhe varrimit të tij. Kronikë për ndërtimin e urës në Myzeqe dhe në Berat. Shkruar nga Nikolla, i biri i Konstandin Nokës.*
- f. 67^v-78^v: Lutje e mëkatarit për të Tërëshenjtën dhe Kryeengjëllin Mikael.*
- f. 79-85^v: Historia e madhe dhe e mrekullueshme e të gjithëurtit mbretit Solomon, që ndërtoi Jerusalemin nëpërmjet demonëve, shkruar nga i shenji Naum.*

Dorëshkrimi ndodhej në Bibliotekën e AQSh. U vendos në Fondin “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja nr. 108.

7. Fletore shënimesh e një nxënësi. Shkruar në gjysmën e dytë të shek. XIX. Përmban 89 fletë letre me përmasa 203 x 145 mm. Dorëshkrimi (figura 6) është pajisur me kapakë kartoni, veshur e lëkurë, pak të dëmtuar. Lidhja e mirë. Përmbajtja:

- f. 1^{r-v}: Shënime të ndryshme, ushtrime të penës.*
- f. 2-33^v: Modele për mbajtjen e korrespondencës mes familjarëve, ushtrime gramatikore në greqisht.*
- f. 34-45^v: Tekst “Për katekizmin”, shkruar me alfabetin e Theodhor Haxhifilipit (Dhaskal Todhrit).*
- f. 46-69: Tekste të ndryshme për ushtrime gramatikore dhe ushtrime gramatikore në greqisht.*
- f. 69^v-70: Fjalorth shqip-greqisht, me germa greke.*
- f. 70^v-82: Tekste të ndryshme për ushtrime gramatikore dhe ushtrime gramatikore në greqisht.*

- f. 82^v-83:** Alfabeti i gjuhës frënge, fjalorth shqip-greqisht dhe ushtrime shkrimi.
- f. 83^v-89:** Ushtrime gramatikore të greqishtes. Mes tyre, në **f. 88^v** një këngë popullore në greqisht, me notacion të muzikës bizantine. Poshtë saj, ushtrime me fjalë shkruar në alfabetin arab.
- f. 89^v:** Kopje e firmës së Patriarkut Ciril të Konstandinopojës dhe kopja e një letre të tij.

Data e shkrimit/kopjimit na është e panjohur, po ashtu dhe autori. Disa herë gjatë dorëshkrimit shfaqet emri Petro Shuteriqi, shkruar me alfabetë të ndryshëm. Fletorja ndodhej në Bibliotekën e AQSh. Iu shtua Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja nr. 109.

8. Fletore shënimesh e një nxënësi. Shkruar në shek. XIX. Përmban 162 fletë letre me përmasa 155 x 110 mm. Fletorja është e pajisur me kapakë kartoni veshur me lëkurë, të dëmtuar. Lidhja ekziston, por është e dëmtuar. Përmbajtja:

- f. 5^v:** Shënime të ndryshme;
- f. 6-7^v:** Fjalor frëngjisht-greqisht, greqisht-frëngjisht dhe shënime;
- f. 8-73:** Fjalor italisht-greqisht, greqisht-italisht, rregulla drejtshkrimore të greqishtes dhe italishtes, shënime kronikale dhe mësimesh;
- f. 73^v-89^v:** *Lexicon latino-graecum*, shënime të ndryshme;
- f. 90-126^v:** Fjalor frëngjisht-italisht, ushtrime gramatikore, shënime me rregulla gramatikore;
- f. 127^v-128^v:** Ushtrime algjebre;
- 139^v-152:** Ushtrime gramatikore, shënime.

Data e kopjimit/shkrimit, si dhe autori, janë anonimë. Hasen të kopjuara disa shënime kronikale që u përkasin viteve 1823-1824. Në f. 8 haset shënimi: Σχολή Κάστρου, 10, shënim i hasur edhe në Koleksionin e Librave të shtypur që vijnë nga shkolla e Kalasë së Beratit. Pasi u gjet në Bibliotekën e AQSh, fletorja iu shtua Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, Dosja nr. 109.

9. Vepra baritore nga Kristofor Shpirtërori, zoti Misail dhe Eugjen Vulgaris. Dorëshkrim i kopjuar në shek. XVIII, përmban 144 fletë letre me përmasa 266 x 177 mm (figura 7). Mbrohet nga kapakë prej kartoni, në

gjendje të mirë. Përmbajtja:

f. 1-6^v: Πίναξ τοῦ βιβλίου.

f. 7-77^v: Πόνημα Χριστοφόρου Πνευματικοῦ (κεφάλαια α' - οθ').

f. 78^{r-v}: Shënim i zotëruesit.

f. 79-129^v: Τοῦ κῦρ Μισαήλ πόνημα.

f. 130-144^v: Ἡ ἐπιστολή τοῦ διδασκάλου κῦρ Εὐγενίου⁶.

Në fletën e parë të dorëshkrimit bie fort në sy një vulë biblioteke. Vula është rrethore, teksti në të thotë: ΣΥΛΛΟΓΟΣ ΦΙΛΟΜΟΥΣΩΝ Η «ΑΝΑΓΕΝΝΗΣΙΣ» ΕΝ ΚΟΡΥΤΣΑ, 1908. Në qendër të vulës dallohet figura e feniksit që rilind nga flakët. Kuptojmë se bëhet fjalë për Shoqatën e Miqve të Muzave, e themeluar në Korçë më 1908⁷, biblioteka e së cilës ka qenë, të paktën për një periudhë kohe, zotëruesja e këtij dorëshkrimi. Në po të njëjtën fletë, në kufirin e poshtëm, hasim shënimin: περί πίστεως, ἐλπίδως καὶ ἀγάπης, βιβλίον ὁποῦ ἐτυπώθη τῷ ,αχνδ' | ἄρθρω ὀγδόω, φύλλα: ρζζ. Φραντζίσκος Πιβάτος, ἐν Βενετία νομοδιδάσκαλος εἰς τὸ ἐπιστημονικὸν λεγιωνόν του (Mbi besimin, shpresën dhe dashurinë, libër që u shtyp në vitin 1654, në format tetësh, përmban 197 fletë. [Shkruar nga] Françesko Pivato, mësues i ligjit në Venedik). Nëse ky informacion është i saktë, libri, nga i cili është kopjuar teksti i dorëshkrimit tonë, është botuar më 1654 në Venecia. Ndërkohë, për sa i përket Françesko Pivatit, na duhet të kërkojmë ende, për ta identifikuar. Në f. 6^v, në fund të tabelës së përmbajtjes, kemi shënimin: 1782, μαρτηίου 1, κατηρχή. | το παρό(ν) βιβλιο ηπαρχη καμου Παρθένιου | ἱερομοναχου, λογοθέτη μακονιάτη, καὶ οποιος μου | το παρη δηχος το θελημάμου ναή ναι αφορισμένος | καὶ ασινχοριτος καὶ μετα θανατο ἀλητος (1782, 1 mars. Ky libër është imi, i Parthenit prift-murgut, logothetit nga Makoniati, dhe kushdo që e merr pa dëshirën time, qoftë i mallkuar dhe të mos i falen mëkatet, dhe pas vdekjes të mos tretet). Veç emrit në zotëruesit, shënimi na jep dhe datën *ante quem* të kopjimit të tij, vitin 1782. Më pas, në f. 78, ndodhet një tjetër shënim i mëvonshëm, i vitit 1857, ku vihet në dyshim autorësia e Kristofor Shpirtërorit për tekstin e parë “Mbi pagëzimin”, por pranohet autorësia e zotit Misail, teksti i të cilit pason shënimin në fjalë (f. 79-129^v). Në po këtë shënim shpjegohet se vepra *Kundër latinëve...* e Eugjen Vulgaris (f. 130-144^v) ka qarkulluar më parë në shtypshkrim.

Dorëshkrimi u gjet në Bibliotekën e AQSh. Iu shtua Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, me nr Dosje 111. Nuk dimë si mbërriti në AQSh. Duke bërë

6 Εὐγένιος Βούλγαρης, *Βιβλιάριον κατὰ Λατίνων ἔχων ὄνομα ἐγκύκλιος ἐπιστολή*, α' ἐκδοση Κωνσταντινουπόλη 1756.

7 *Κανονισμὸς τοῦ ἐν Κορυτσαῖ Συλλόγου τῶν Φιλομούσων «Ἡ Αναγέννησις»*, Ἐν Θεσσαλονίκῃ, 1908.

një lidhje hipotetike mes vulës së Shoqërisë së Miqve të Muzave në f. 1 dhe etiketës së një biblioteke në shpinën e librit (etiketa jep të dhënat: Dol. A. Seria 3. Nr. 90 (28), 24), hamendësojmë se kemi të bëjmë me një njësi të një biblioteke që ka pasur edhe të tjerë libra në zotërim. Ndërkohë, duke dalë jashtë Koleksionit të Kodikëve, po t'i hedhim një sy Koleksionit të Librave të shtypur në greqisht⁸, do të shohim se po të njëjtën etiketë e hasim edhe tek librat e shtypshkruar. Dorëshkrimi në fjalë lidhet me të njëjtin koleksion më të hershëm, por ende e kemi të pamundur të argumentojmë lidhjen mes këtyre librave, si dhe historinë e tyre.

10. Psalmet e Davidit dhe Nëntë Odet. Libri në fjalë është një libër i shtypshkruar, i cili, pas dëmtimit, është restauruar dhe i janë shtuar fletë të shkruara me dorë, për të zëvendësuar fletët e dëmtuara (figura 8). Libri përmban, gjithsej, 133 fletë letre, nga të cilat 17 janë shkruar me dorë, të tjerat janë shtypshkrime. Si fletët e shtypura, ashtu dhe ato të shkruara, kanë të njëjtat përmasa, 195 x 135 mm. Përmbajtja e librit:

f. 1^r-121^r: Ψαλμός θ', inc. ...ἀσθενήσουσι καὶ ἀπολοιῶται ἀπὸ προσώ|που σου.... Ψαλμός ρμ', des: ... Πᾶσα πνοὴ αἰνεσάτω τὸν Κύ(ριον).

f. 121^r-121^v: Ψαλμός ρμα', Οὗτος ὁ ψαλμός ἰδιόγραφος τοῦ Δαβίδ ἐστὶ καὶ ἐξῶθεν τοῦ ἀριθμοῦ τῶν πεντήκοντα ψαλμῶν, ὅτε ἐμονομάχησε πρὸς τὸν Γολιάθ.

f. 121^v-133^v: Αἱ Ἑννέα Ὠδαί.

Si për kohën dhe vendin e shtypshkrimit, për fletët e shtypshkrura, ashtu dhe për datën e kopjimit, kopistin dhe vendin e kopjimit të fletëve të dorëshkruara, nuk kemi informacion. Libri ka të numërtuar katër fletët e para që çdo fashikulli dhe të gjitha fletëve, më pas, u është shtuar numërtimi i AQSh. Sipas këtij numërtimi, fletët e shkruara me dorë janë: 1-11, 50, 59, 111, 112, 132, 133. Libri është i pajisur me kapakë druri të veshur me lëkurë, e cila dekorohet me motive rombesh, të vendosura brenda një drejtkëndëshi vertikal me vija dhe rrathë. Rombet dhe hapësirat boshe mes motiveve mbushen me lule zambaku trefletëshe. Në buzët e kapakëve shihen gjurmë të një mbërthecke. Lidhja është e mirë, e stilit bizantin. Në anën e brendshme të kapakut është ngjitur një etiketë me nr. 23. Në fletën 1 dhe 5 ndodhet nga një vulë e Bibliotekës së AQSh me nr. 44, numër të cilin mbante libri në Koleksionin e Librave të Rrallë të AQSh. Prej këtij koleksioni (pjesë e Bibliotekës së AQSh), libri u vendos në Fondin "Kodikët

8 Shih, në po këtë botim të praktikave të konferencës: A. Rembeci & S. Çunga, "Koleksioni i librave të vjetër të AQSh shtypur në greqisht".

e Shqipërisë”, me nr. Dosjeje 112.

Duke pasur parasysh dorëshkrimet e tjera të Fondit “Kodikët e Shqipërisë”, duam të vëmë në dukje ngjashmërinë që paraqet shkrimi i kopistit të librit tonë, me një nga dorëshkrimet e tjera të këtij Fondi, atij me nr. Dosjeje 66 (figura 9). Ky është një dorëshkrim në letër, që përmban tekstin e një *Nomokanoni*, kopjuar më 1612 nga Gjinoja, prift dhe ikonom i Mitropolisë së Hirëshme të Pogonit. Për të qenë të sigurt se kemi të bëjmë me të njëjtin kopist, në mungesë të shënimit kodikografik, do të na duhej të kryenim një ekspertizë më të hollësishme se ajo që patëm mundësi t’u bëjmë dy shkrimeve. Pa marrë pozita absolute, mund të themi se ngjashmëritë e shkrimit duken tek: 1) germat nistore kapitale; 2) ductus-i i shkrimit; 3) shënimi në fund të librit (figura 10). Gjinoja i Pogonit është një nga kopistët më me përvojë dhe me më shumë prodhimtari gjatë kohës kur jetoi dhe punoi. Veprimtaria e tij libërshkruese mbulon gjysmën e parë të shek. XVII dhe, sipas Linos Politis, ka kopjuar 25 dorëshkrime⁹. Ndoshta kjo prodhimtari e madhe e ka bërë Gjinoja të mos lërë shënimin kodikografik edhe në fund të fletëve të librit të Psalmeve, siç ka bërë tek të gjithë dorëshkrimet e tjerë të kopjuar prej tij.

Teksa kemi hapur këtu parantezën lidhur me kopistin Gjino, shohim se tek lista e librave të kopjuar prej tij, e cila na jepet e plotë prej Linos Politis, nuk përmendet *Nomokanon*-i i ndodhur në Fondin “Kodikët e Shqipërisë” të AQSh. Kështu, numrit mbresëlënës prej 25 kodikësh të kopjuar nga Gjinoja, i shtojmë edhe kodikun e Beratit, Fondi “Koleksioni i Kodikëve të Shqipërisë”, Dosja 66, duke e çuar në 26 numrin e librave kopjuar prej Gjinos, si dhe fletët e ndodhura tek Psalmet e Davidit, tashmë me referencën e re, Fondi “Koleksioni i Kodikëve të Shqipërisë”, Dosja 112.

11. Diptikë të Manastirit të Filanthropit (Ἀρχὴ τῶν Διπτύχων τῆς Μονῆς τοῦ Φιλανθρώπου). Dorëshkrim në letër (figura 11), që siç e thotë dhe vetë titulli, përmban emrat e dhuruesve të manastirit, që kujtohen gjatë shërbesave të ndryshme fetare. Dorëshkrimi përmban 70 fletë me përmasa 220 x 150 mm dhe është shkruar me bojë kafe. Lidhja është e ruajtur, por me dëmtime. Nga dy kapakët, ruhet i dëmtuar vetëm kapaku i sipërm, i cili përbëhet nga një dërrasë e mbuluar me lëkurë, pa dekorime, por me një gozhdë me kokë të rruzullt në qendër. Fleta 16^r e dorëshkrimit përmban një dekor mbititullor të thjeshtë, në formë shiriti që formohet prej vijave zig-zage, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën dhe japin pamjen e një shiriti me gjemba. Poshtë këtij dekori na jepet titulli i lëndës: Ἀρχὴ τῶν Διπτύχων τῆς Μονῆς τοῦ Φιλανθρώπου (*Fillimi i diptikëve të Manastirit*

9 Për më shumë shih: Λίνος Πολίτης, «Γκίνος ἱερεὺς καὶ οἰκονόμος Παγωνιανῆς», tek *Ελληνικά*, 25/1, 1972, fq. 109-118.

të *Filanthropit*). Përmbajtja e dorëshkrimit renditet si më poshtë.

f. 1-35^r: Ἀρχὴ τῶν Διπτύχων τῆς Μονῆς τοῦ Φιλαν(θρώπου).

f. 47^r: Odet 7, 8, 9 nga Zbritësoret e Ngritjes së Kryqit të Nderuar.

f. 48^v: Diptikë.

f. 49^r-58^v: Pjesë nga *Minaion* e muajit gusht, data 15, Metamorfoza e Zotit Jezu Krisht.

Duke gjykuar nga *ductus*-i i shkrimit, teksti është shkruar në shek. XIV, me prirje për nga dekadat e mesit të këtij shekulli. Në f. 27 të dorëshkrimit hasim shënimin: “Τῷ αὐτῷ μηνὶ εἰς τὴν κε’ ἐκοιμοίθη Κομνηνός Ἰω(άννης) ὁ Δεσπότης, ἔτος ,στωξή””, (Po këtë muaj, mëdhatë 25, fjeti Joan Komneni Dhespoti, viti 6868) ku jepet qartë data 25 nëntor e vitit 6868 (= 1360), datë të cilën e marrim si *post quem* për kopjimin e teksteve. Ndërkohë që tekstet e tjera (Odet e Zbritësoreve të Ngritjes së Kryqit) gjykojmë se janë kopjuar në një periudhë më të vonë, në fund të shek. XIV apo fillim të shek. XV. Dorëshkrimi është shkruar nga disa duar të ndryshme.

Dorëshkrimi në fjalë u gjet në Bibliotekën e AQSh. Nuk dihet udhëtimi që ka ndjekur deri këtu, ashtu si shumë libra të shtypur dhe dorëshkrime të tjera. Prezantimin e parë me të na e bën Pierre Batiffol, kur më 1887 na jep një përshkrim të kodikëve që ndodheshin në bibliotekën e Mitropolisë së Beratit¹⁰. Në numrin VII të katalogut të tij përmend *Diptikët* tanë dhe, duke u mbështetur tek një botim i Konstandin Sathës¹¹, lidh këtë dorëshkrim me Manastirin e *Filanthropit* që ndodhet në Janinë. Që prej vitit 1887, kur e përmend Batiffol, deri nuk dimë të jetë përmendur më në ndonjë botim tjetër. Dorëshkrimi u shtua në Fondin “Koleksioni i Kodikëve”, me nr. dosjeje 113.

Siç e pamë nga kjo paraqitje e shkurtër, në AQSh kemi ende dorëshkrime të tjera të panjohura për studiuesit. Lënda e tyre është e larmishme: nga interpretimi i ëndrrave, tek letrat baritore dhe diptikët, nga fjalorët dhe ushtrimet gramatikore, tek tekstet me alfabet të Dhaskal Todrit, apo tekste në gjuhën vllahe shkruar me alfabet greqisht. Po ashtu, prejardhja e këtyre dorëshkrimeve apo zotëruesit e tyre para se të bëheshin pjesë e AQSh është një tregues që dëftën, përsëri, ushqimin e përditshëm të përdoruesve apo krijuesve të tyre, jetën e përditshme të paraardhësve. Dhe, në kontekstin e kësaj konference, këta libra shërbejnë për të treguar marrëdhëniet kulturore mes shqiptarëve dhe grekëve gjatë periudhës së Perandorisë Osmane.

10 Pierre Batiffol, *Les manuscrits grecs de Bérat d’Albanie et le Codex Purpureus Φ*, tek: “Archives des missions scientifiques et littéraires”, 3^e série, Paris, 13 (1887), fq. 11.

11 Constandine Sathas: *Bibliotheca graeca medii aedi*, t. III, 1872, fq. XCVII

Bibliografia

- Maria Mavroudi, *A Byzantine Book on Dream Interpretation, the Oneirocriticon of Achmet and its Arabic Sources*, Brill 2002.
- Pierre Batiffol, *Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le Codex Purpureus Φ*, tek: "Archives des missions scientifiques et littéraires", 3^e série, Paris, 13 (1887).
- Ἀνθιμος Ἀλεξούδης, *Σύντομος Ἱστορική Περιγραφή της Ἱερᾶς Μητροπόλεως Βελεγράδων*, ἐν Κερκύρα, 1868.
- Εὐγένιος Βούλγαρης, *Βιβλίριον κατὰ Λατίνων ἔχων ὄνομα ἐγκύκλιος ἐπιστολή*, α' ἐκδοση Κωνσταντινούπολη, 1756.
- Αἶνος Πολίτης, «Γκίνος ἱερεὺς καὶ οἰκονόμος Πωγωνιανῆς», tek *Ελληνικά*, 25/1, 1972.
- Κανονισμὸς τοῦ ἐν Κορυτσαῖ Συλλόγου τῶν Φιλομούσων «Ἡ Αναγέννησις», Ἐν Θεσσαλονίκη, 1908.




Figura 1: Oneirokritikon nga Ahmet ibn Sirim.




Figura 2: Nomokanon, i tipit pānu wfélimon kai plousiwátaton




Figura 3: Gjeografi, nga Athanas Psalidha.




Figura 4: Liturgji të Shën Joan Gojartit dhe Shën Vasilit, në greqisht dhe vllahisht.




Figura 5: Fletore shënimesh. Shkruar nga Joan dhe Athanas Kolotova, 23 shkurt 1868.




Figura 6: Fletore shënimesh. Fleta 34 (djathtas), tekst shkruar me alfabetin e Theodhor Haxhifilipit, Për katekizmin.




Figura 7: Vepra baritore nga Kristofor Shpirtërori, zoti Misail dhe Eugjen Vulgaris.




Figura 8: Psalmet e Davidit dhe Nëntë Odet. Majtas dorëshkrimi, djathtas shtypshkrimi.




Figura 9: Psalmet e Davidit, kopjuar nga Gjinoja (majtas - F. 488, D. 112), Nomokanon (djathtas - F. 488, D. 66), kopjuar më 1612 nga Gjinoja, prift dhe ikonom i Mitropolisë së Pogonit.




Figura 10: Kolofonet në fund të *Psalmëve të Davidit* (majtas - F. 488, D. 112) dhe *Nomokanon-it* (djathtas - F. 488, D. 66).




Figura 11: *Diptikët e Manastirit të Filanthropit.*